


PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

EMËRTIMI I PROJEKTIT:
"INSTALIM IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA"

VENDNDODHJA E ZONËS SË ZHVILLIMIT:
PARKU INDUSTRIAL RRASHBULL, DURRËS
Zona Kadastrale 2591
Parcela me Nr. Pasurie 1
Sipërfaqe e përgjithshme: 580.6 m²

Hartoi:
Ekspert Mjedisi i licencuar
KLEVIS BREGU



Për investitorin:
BREMA AMBIENTE SH.P.K
Administratori
SELIM BREGU



BREMA AMBIENTE SH.P.K

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| 1. PËRSHKRIMI I OPERATORIT DHE PROJEKTI..... | 3 |
| 2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT..... | 4 |
| 3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE QËLLIMI..... | 7 |
| 4. PROCESI TEKNOLOGJIK..... | 8 |
| 5. MENAXHIMI I INSTALIMIT..... | 15 |
| 6. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS..... | 1 |
| 7. MASAT KRYESORE LEHTËSUERE..... | 5 |
| 8. MONITORIMI I PLANIFIKUAR..... | 7 |



- ✓ Impianti është i destinuar për trajtimin kimiko-fizik, me përdorimin e agjentëve kimiko-fizikë, të ujërave të ndotura teknologjike; ujërat e kullimit të landfillit (leksiviatet), për ta bërë atë të trajtueshëm në një impiant biologjik të mëvonshëm.
- ✓ Furnizimi me energji elektrike: Tension 380/400 V (3F + N + T)
- ✓ Rryma me ngarkesë të plotë: 63 A
- ✓ Fuqia maksimale e absorbuar: 25 kW
- ✓ Uji i pijshëm/industrial në hyrje: Rrjedha e kërkuar 150 – 300 l/min në 2-
- ✓ Kapaciteti i trajtimit: 3 bar
- ✓ Shpejtësia maksimale e prurjes: 5 m³/h
- ✓ Funksionimi: I vazhdueshëm (24 h)

2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Shoqeria "BREMA AMBIENTE" SH.P.K ushtron aktivitetin e saj ne adresen: Parku Industrial Rrashbull, Manskuri, Durres dhe Nr. NIPT: L22316011G.

Territori ku shoqeria zhvillon aktivitetin e saj nuk cenon territoret e zonave te mbrojtura mjedisore, kurores se gjelber, hapesires ujore rekreative, parkut urban, zonave te caktura per agroturizem, kala, objekte fetare, rrenoja/arkeologji, ujera siperfaqesore etj.

Ajo gjithashtu eshte larg zonave te banuara, shkollave dhe kopshteve.

E gjithë sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti:

"Instalim impianti për trajtimin e ujërave të ndotura", do të zhvillohet ne parcelen me Nr. Pasurie 1. (fig. si me poshte).

1. PËRSHKRIMI I OPERATORIT DHE PROJEKTI

Të përgjithshme

Ky relacion joteknik hartohet me kerkese te zhvilluesit "BREMA AMBIENTE" SH.P.K me nr. NIPT: L22316011G, i cili do te paraqese prane Agjencise Kombetare te Mjedisit dokumentacionin e nevojshem per ndryshim te kushteve te lejes se mjedisit te tipit A, Nr: PN-0874-12-2021, per aktivitetin:

"Instalim impianti për trajtimin e ujërave të ndotura".

me vendndodhje Rrashbull, Manskuri, Bashkia Durrës, Rrethi Durrës, Qarku Durrës – Parku Industrial Rrashbull.

Zhvilluesi i aktiviteteve eshte shoqeria "BREMA AMBIENTE" SH.P.K, me vend ushtrimi aktiviteti: Parku Industrial Rrashbull, Manskuri, Durres.

Qellimi i kesaj kerkese eshte ndryshim i kushteve te lejes mjedisore te tipit A, qe subjekti zoteron me numer leje: PN-0874-12-2021, duke qene se do beje shtimin e teknologjive te reja ne aktivitetin e tij.

Ky projekt per vleresim po kryen njoftimin per proceduren e degjeses me publikun sipas VENDIM Nr. 419, datë 25.6.2014 dhe me pas do te kryeje te gjitha hapat per ndryshim te kushteve te lejes mjedisore, aktualisht ka kryer aplikimin per Vleresimin Paraprak te Ndikimit ne Mjedis per kete aktivitet.

Sipas LIGJIT Nr. 10 448, datë 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", Shtojca I:

Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi; per instalimin qe do kryhet, kemi klasifikimin sipas ID te meposhtme:

Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza

ID 6.2. Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen.

Të dhëna teknike:

Siperfaqja totale e vendit ku do te zhvillohet projekti nga subjekti BREMA AMBIENTE SH.P.K eshte 580.6 m², me shtrirje ne zonen kadastrale 2591.



Specifikime teknike:

- ✓ Kapaciteti i projektuar i trajtimit te ujeravve te ndotura eshte **4.5 - 5 m³/h.**

ZONA KU DO TË ZHVILLOHET PROJEKTI



**Zona Kadastrale 2591
Parcela me Nr. Pasurie 1
Sipërfaqe e përgjithshme: 580.6 m²**



3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE QËLLIMI

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte konsiston ne gjetjen e alternativave miqesore me mjedisin:

- Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti.
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese dhe nevojen per infrastrukture te re per projektin.

Identifikimi i ndikimeve

Permes te cilit percaktohet nderveprimi mjedis-projekt dhe identifikohen ndikimet e mundshme.

Vleresimi i ndikimeve

Vleresimi i ndikimeve ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafrohet me objektivist me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

Shtrirja fizike

Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinor te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim.

Kohezgjatja e ndikimit

Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).

Kthyeshmeria

Vlereson mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te mepareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar).

Rendesia

Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekoheisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Qellimi i projektit te propozuar ne kete permbledhje joteknike konsiston ne instalimin e nje impianti i cili eshte i destinuar per trajtimin kimiko-fizik, me perdorimin e agjentëve kimiko-fizikë, të ujërave të ndotura të kullimit të landfillit (leksiviatet), për ta bërë atë të trajtueshëm në një impiant biologjik të mëvonshëm.

4. PROCESI TEKNOLOGJIK

IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA TË LANDFILLIT (LEKSIVIATE)

Kapaciteti i trajtimit te ujerave te ndotura = 5 m³/h

TË DHËNA TEKNIKE

Impianti është i destinuar për trajtimin kimiko-fizik, me përdorimin e agjentëve kimiko-fizikë, të ujërave të ndotura të kullimit të landfillit (leksiviatet), për ta bërë atë të trajtueshëm në një impiant biologjik të mëvonshëm.

Kapaciteti i impiantit

- Furnizimi me energji elektrike: Tension 380/400 V (3F + N + T)
- Rryma me ngarkesë të plotë: 63 A
- Fuqia maksimale e absorbuar: 25 kW
- Uji i pijshëm/industrial në hyrje: Rrjedha e kërkuar 150 – 300 l/min në 2-
- Kapaciteti i trajtimit: 3 bar
- Shpejtësia maksimale e prurjes: 5 m³/h
- Funkcionimi: I vazhdueshëm (24 h)

Dimensionet

Dimensionet e platformës bazë (L x P x H) m = 7.5 x 2.6 x 3.0

S_{bazës} = 19.5 m²

Masa e zbrazët = rreth 8 TON

Masa e ngarkuar plotësisht = afërsisht 22 TON

Procesi i punës (Funksionimi)

Nëpërmjet pompës së ngarkimit të ujit (P1), duke modifikuar frekuencën nëpërmjet inverterit, bazuar në shpejtësinë e rrjedhës së vendosur në panel dhe të matur me M1 (matës i rrjedhës së ujërave të zeza), transferohen ujërat e ndotura nga rezervuarët S1, S2 dhe S3 në rezervuarin S4, duke kaluar përmes filtrit të kazanit, për të ndarë çdo lëndë të ngurtë të pranishme në ujërat e ndotura. Gjatë ngarkimit, valvula EV1 mbetet e hapur për të lejuar transferimin e ujërave të ndotura. Funksionimi i filtrit FT1 shoqërohet me hapjen e valvulës EV2 të ujit të rrjetit të larjes. Në rezervuarin e reaksionit S4 ka një sondë PH, që përdoret për leximin dhe kontrollin e dozave kimike, që kryhet nëpërmjet pompave dozuese PD1, PD2, PD3.

Pompa dozuese (PD1) fut H_2SO_4 në 50%;

Pompa dozuese (PD2) fut 30% NaOH;

Pompa dozuese (PD3) fut PAC sol.16-18%.

Procesi zhvillohet në një cikël të vazhdueshëm dhe dozat zhvillohen automatikisht, sipas vlerës së PH të zbuluar, me qëllim stabilizimin e PH midis min. 5.5 dhe 7.5 max.

Në të njëjtin rezervuar S4 injektohet një koagulant për të mundësuar pastrimin-flokulimin e llumit me anë të një përzierësi (AG1), me anë të të cilit do të bëhet përzierja e përbërësve kimikë. Rezervuarët S4, S5 dhe S6 komunikojnë nëpërmjet një pendeleje; ky kalim "i qetë" ndërmjet një dhome në tjetrën lejon që llumi të vendoset në pjesën e poshtme të konit të cunguar të çdo rezervuari dhe të nxirret në fund të procesit. Njëkohësisht me dozimin e kimikateve, faza e sedimentimit fillon në secilën prej tre tankeve S4-S5-S6; me pompën P1 aktive, cikli i hapjes me pauzë pune që mund të vendoset në panel do të vijojë për valvulat EV4-EV5-EV6 dhe, me pompën P2, do të fillojë nxjerrja e llumit në rezervuarin S9.


Nxjerrja e llumit do të bëhet gjithashtu vetëm nëse njëra nga tre valvulat EV4-EV5-EV6 është e hapur.

Shpejtësia e rrjedhës së nxjerrjes së llumit matet me anë të M2 (matësit të rrjedhës së nxjerrjes së llumit).

Nga rezervuari S6, ujërat e ndotura të trajtuara përcillen në rënie në rezervuarin e sedimentimit të paketës lamelare ku, me anë të pendeles, shkarkohet në S8. Ujërat e ndotura, pasi kanë arritur në rezervuarin e rinisjes, përcillen në filtrat e kuarcitit dhe karbonit nëpërmjet pompës P3, për t'u dërguar më pas në shkarkim. Leximi kryhet nëpërmjet M3 (matësit të rrjedhës së daljes).

Në këtë fazë të punës, nëse transduktori TP1 zbulon një presion më të lartë se vlera e vendosur në panel, aktivizohet Bypass-i i filtrave, përmes hapjes së EV3, i cili e përcjell atë në kullues.

I gjithë sistemi menaxhohet automatikisht nga PLC dhe mund të kontrollohet dhe shfaqet nga distanca për menaxhimin e saktë të parametrave.



IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA TË TEKNOLOGJIKE

Kapaciteti i trajtimit te ujerave te ndotura = 4 m³/h

(Ujërat e ndotura të industritve të përpunimit të metaleve; xingimi i hekurit; galvanizimi i zinkut etj.)

1. Pompa e futjes se influentit (ujit te ndotur).
2. Presfiltër me presion të lartë (10 ton).
3. Depozitë Konike; përzierja e ujërave të ndotura.
4. Tre (3) depozita vertikale me diametër Ø 85.
5. Sistemi i kazaneve (katër aditive me dozim automatik);

Acid Sulfurik

Hipoklorit Alumini

Gëlqere pluhur (CaCO₃)

Sode kaustike

6. Sistemi i pompave -Mbledhja e ujit të trajtuar ; Mbledhja e Sludge (llumërave).
7. Tre (3) Flitra (diametër Ø 95) ; - rërë kuarci (2) ; karbon aktiv (1).

- 8. Kompresori i ajrit).
- 9. Panel Kontrolli / Elektrik

OSMOZA E KUNDËR / OSMOZA ME DISQE TUBULARE

Të dhëna teknike

DIMENSIONET 104" x 88" x 84"

8000 ibs

Kërkesat për fuqi

35 kW

208 VAC, 3-FAZË, 60 Hz, 104 amp

Gjenerator i serisë 806 60 kW me lidhje me fuqi 200 amp (minimumi)

35 kW, 208 V, tela 5 faza 3, 60 Hz, 104 ampera (MEPP 6 ose më e madhe)

Lidhja 200 amp

Pjesët përbërëse

- 2 pompa uji; për ujërat e ndotura të papërpunuara
- 1 Pompë shpërndarjeje
- Seksioni i pastrimit me 1 element
- Sistemi i strukturës së marrjes së ujit
- 4 tanke NBC (2 radiologjike/ 2 biologjike)
- 5 kuti veglash
- Gypat e murit të fortë/të butë
- Përshtatës elektrik

EVAPORATORI

Njësitë përbërëse:

(1) Ftohës vertikal me blic, Model FC-1, çelik inox 304.


(2) Diametri i përafërt 40" x 108" i gjatë, i brendshëm i vlerësuar me vakum të plotë/15 PSI në 250 gradë F., montime anësore, të certifikuara nga Walker Stainless, National Board # 988, Serial # 3565.

(3) Kondensator vertikal i ftohësit, Model FCC-1, çelik inox 316.

Përafërsisht 220 m².

(4) Diametri i përafërt 16" x 180" i gjatë, nga ana e tubit të vlerësuar me vakum të plotë/15 psi në 250 gradë F., nga ana e guaskës me vakum të plotë/75 psi në 250 gradë F., montimet anësore me prizë, të certifikuara nga Walker Stainless, National Board # 990. Seriali # 3563.

IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA TEKNOLOGJIKE



BREMA AMBIENTE

PËRSHKRIMI TEKNOLOGJIK I AKTIVITETEVE

Aktiviteti ka si qëllim instalimin e një impianti të trajtimit të ujërave të ndotura në një sipërfaqe të konsiderueshme të lirë nga ndërtimet. Qëllimi i këtij aktiviteti është trajtimi i ujërave të ndotura nga proceset teknologjike. Të gjitha proceset e punës që nga sigurimi i lëndëve të para e deri në përfundim do të zbatohen konform akteve ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

Ne kete projekt nuk do te zhvillohen procese ndertimore. Proceset te cilat do te ndermerren kane te bejne me instalim impianti per ujerat e ndotura ne nje siperfaqe ekszituese. E gjithë siperfaqja është e betonizuar.

Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lëndët e para, që do të përdoren në këto aktivitete do të jenë ujërat e ndotura të landfillit (leksiviatet). Gjithashtu si lëndë të para në proces do të hyjnë ujërat e ndotura acide nga industri të ndryshme; industria e përpunimit të metaleve (xingimi i hekurit; galvanizimi i zinkut etj).

Lëndë të para ndihmëse, janë energjia elektrike dhe uji.

Energjia elektrike do të sigurohet nga kabina elektrike në funksionim brenda ambjentit të Parkut Industrial.

Furnizimi me ujë do të sigurohet nga një pompe zhytëse, e aftë për të furnizuar, nëpërmjet tubave PE, ujërat e ndotura industriale do të trajtohen duke hyrë në impiantin e pastrimit, me shpejtësi rrjedhjeje midis 150 - 600 l/min.

Në të katërta skajet e pozicionimit të kësaj teknologjie janë të vendosura distributoret e ujit që përdoren për proceset e punës, që mund të nevojiten për proceset e ndryshme të pastrimit të pjeseve perberese te makinerise.

Tabela 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUS-KRUGER

| KOORDINATAT SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGER | | |
|---|-------------|-------------|
| | (E) | (N) |
| 1. | 4378809.666 | 4575234.438 |
| 2. | 4378786.607 | 4575247.167 |

| | | |
|----|-------------|-------------|
| 3. | 4378812.559 | 4575268.336 |
| 4. | 4378796.377 | 4575274.778 |

Tabela 2 Koordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH

| KOORDINATAT SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV KRGJSH | | |
|--|------------|-------------|
| | (E) | (N) |
| 1. | 462430.990 | 4574187.928 |
| 2. | 462407.789 | 4574200.388 |
| 3. | 462433.492 | 4574221.851 |
| 4. | 462417.239 | 4574228.105 |

5. MENAXHIMI I INSTALIMIT

Aktivitetet e parashikuara marrin ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjelle deme mjedisit, vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren dhe faunen.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa demtuar peisazhin.

Një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masa teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Në këtë aktivitet të subjektit do te punesohet nje numer prej **3-5 punonjësish** për kryerjen e punës dhe funksionimin e saj në vazhdimësi.

Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloj mbetjeje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë probleme mjedisore të përkohshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës, së bashku me zhvillim e madh që është bërë në industri të ndryshme.

Mbetjet industriale të patrajtuara, emetimet e gazeve të dëmshme në atmosferë, përdorimi i kimikateve pa marrë parasysh dëmet që mund ti sjellin mjedisit kanë sjellë problemet mjedisore me të cilat ne përballlemi ditët e sotme. Siperfaqja ku planifikohet te zhvillohen keto aktivitete eshte e paperdorshme momentalisht. Siperfaqe me perdorim ekzistues te pashfrytezuar.

| KUSHTET E PUNËS | | | | | |
|---------------------------------|--|----------|--|------------|----------|
| Numri total i punonjësve | 3-5 | | | | |
| Shpërndarja e punonjësve | ZYRA | PRODHIMI | MIRËMBAJTJA | MAGAZINIMI | TË TJERA |
| | 1 | 2 | 1 | - | 1 |
| Turnet dhe aktivitetet | Zyrat / Administrata | | Instalimet | | |
| | 8 ore 08 ⁰⁰ - 16 ⁰⁰ | | 8 ore 08 ⁰⁰ - 16 ⁰⁰ | | |

| | | |
|---|--|---|
| Orët e punës | Zyrat / Administrata | Instalimet |
| | 2 pax - 8 orë/ditë = 4.992 orë/Vit | 2 pax - 8 orë/ditë = 4.992 orë/Vit |
| Numri i orëve të punës në vit | 4.992 ore/vit + 44.928 ore/vit = 49.920 ore/vit | |
| Numri i ditëve të punës në vit | 312 Ditë/vit | |
| Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet | Pushimet | Dita e diel është pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 24 ditë pushimi në vit. |
| | Ndërprerje të rregullta të funksionimit | Aktiviteti nuk ka ndërprerje të rregullta të funksionimit. |

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Infrastruktura rrugore është ekzistuese kështu që nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja.

Impianti që do të instalohet është brenda ambienteve ku zhvillon aktivitetin industrial kompania

Brema Ambiente Sh.p.k dhe rruget janë të shtruara dhe të sistemuara.

6. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS

| NDIKIMI NE AJER | IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT | | | |
|-----------------------------|---------------------------------|--------|--|--------|
| | PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | | NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | |
| | Ka | Nuk ka | Ka | Nuk ka |
| Emetim i lëndëve të veçanta | | X | | X |
| Aroma sulmuese | | X | | X |
| Ndikime të tjera klimatike | | X | | X |

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka emetime në ajër. Impianti kryen punën e tij në një cikël të mbyllur dhe nuk ka shkarkime të gazeve të demshme për mjedisin. Të vetmet shkarkime mund të jenë pluhurat nga levizja e mjeteve të transportit, nga transporti i lëndës së parë, por që këto mjete do të kontrollohen periodikisht dhe do të mirembahen për të patur shkarkime minimale.

| NDIKIMI I ZHURMAVE | IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT | | | |
|--|---------------------------------|--------|--|--------|
| | PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | | NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | |
| | Ka | Nuk ka | Ka | Nuk ka |
| Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i punës së pjesëve përbërëse të impiantit | | X | | X |
| Nivel më të lartë të zhurmave për njerëzit | | X | | X |
| Nivel më të lartë të zhurmave për kafshët | | X | | X |

Nuk ka vibrime shqetësuese në zonën e objektit. Zhurmat në këtë zonë janë gjithashtu të papërfillshme, ato plotësojnë normativat sipas legjislacionit në fuqi.

Aktiviteti; objekti: Impiante per trajtimin e ujerave te ndotura nuk përfshin procese pune të komplikuara. Në rast të emetimit të zhurmës, ai duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet e Udhëzimit Nr. 5, datë 26.11.2010 "Për lejet e thjeshta mjedisore të cilat lëshojnë zhurma në mjedis", Udhëzimin nr.8 date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara", i cili percakton vlerat e lejuara te zhurmes.

| NDIKIMI NE UJE | IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT | | | |
|--|---------------------------------|--------|--|--------|
| | PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | | NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | |
| | Ka | Nuk ka | Ka | Nuk ka |
| Ndikimet e projektit në modelin e dranazhimit të tokës | | X | | X |
| Ndryshimet e nivelit të ujërave | | X | | X |
| Ndikimet e ndotësve në cilësinë e ujit | | X | | X |

Nuk kemi ndotje të ujërave sipërfaqësore-nëntokësore apo tokës. Ujërat që dalin nga aktiviteti (impiant i trajtimit te ujerave) do te jene ujera te trajtuara, te cilat do te shkarkohen ne ujërat sipërfaqësore të zonës (lagunazhi natyror), brenda të gjitha parametrave mjedisore sipas legjislacionit në fuqi, bazuar vendimit:

VENDIM Nr. 177, datë 31.3.2005 "PËR NORMAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE TË LENGËTA DHE KRITERET E ZONIMIT TË MJEDISEVE UJORE PRITËSE".

Ndikimi i aktivitetit ne ujera sipërfaqesore dhe nentokesore gjate fazes se operimit jane te paperfillshme.

| NDIKIMI NË TRASHËGIMINË KULTURORE | IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT | | | |
|-----------------------------------|---------------------------------|--------|--|--------|
| | PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | | NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË | |
| | Ka | Nuk ka | Ka | Nuk ka |

| | | | | |
|---|--|---|--|---|
| Ndryshime apo dëmtim të zonave arkeologjike, apo me vlera historike e kulturore | | X | | X |
|---|--|---|--|---|

NDIKIMI NE TOKE

I gjithë procesi kryhet në ambient të shtruar me beton dhe të izoluar nga depertimi në sipërfaqen e tokës. Pra, aktiviteti nuk shkakton ndikime në tokë. I vetmi ndikim mund të ndeshet nëse kemi rrjedhje aksidentale të lengjeve të ndotura nga një avari me pasoje ndotje të tokës. Për të tilla incidente do të merren masa për izolimin total të mjeteve teknologjike dhe të gjitha kushtet e domosdoshme që ato duhet të kenë për një transport sa më të sigurt dhe pa ndikime në mjedis.

NDIKIMI NE KLIME

Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon fare në kushtet klimaterike të kësaj zone.

RREZATIM JO-JONIZUES

Aktiviteti nuk shoqërohet me rrezatim jo-jonizues.

NDIKIMI NE POPULLESI

Realizimi i projektit nuk do të ketë ndikime në levizjen apo zhvendosjen e popullsisë së rajonit ku do zbatohet projekti. Gjatë funksionimit të impiantit nuk ka emetime në ajër, tokë apo ujë të cilat ndotin ambientin dhe të rrezikojnë shëndetin e punonjësve apo të popullsisë së rajonit.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë pa elemente të spikatur të flores dhe faunes. Kështu që zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ndikon në të. Subjekti do të shtojë sipërfaqet e gjelberta për një pamje vizuale më të kënaqshme për syrin dhe për të mirat në pikepamjen mjedisore.

MBETJET

Nga proceset e punës së këtij instalimi nuk gjenerohen mbetje. I vetmi gjenerim është ai i llumrave të dalta nga impianti i trajtimit të ujerave.

*** *Specifikim:*

Keto llumra të gjeneruara do të trajtohen brenda ambienteve të Parkut Industrial në landfillin e mbetjeve.

Mbetjet e tjera te ngurta qe do te gjenerohen nga ky aktivitet do te jene mbetjet e ngurta urbane si plastike, leter e karton dhe mbetje te perziera urbane nga personeli. Keto lloj mbetjesh grumbullohen fillimisht ne kontenier ne ambjentet e aktivitetit dhe menaxhimi i tyre do te behet po ne zonen e Parkut Industrial te Rrashbullit. Grumbullimi i mbetjeve do te jete i diferencuar qe ne vendburim.

7. MASAT KRYESORE LEHTËSUESE

Masat lehtësuese që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga kontratuesit për zbatimin e projektit. Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulëta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë shënuar.

Lloji i masave për mbrojtjen e mjedisit ndahen në:

1. Masa teknike
2. Masa organizative

Kuadri i masave Teknike dhe Organizative

| MASA | MËNYRA |
|-----------------------|--|
| Kontrolluese | - Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit. - Kontrolli periodik i gjendjes të pajisjeve/makinerive. - Zbatimi rigoroz i sigurisë gjatë punës. |
| Ndërhyrëse | - Riparim i menjëhershëm i defekteve dhe avarive të pajisjeve. - Njoftim i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca). |
| Administrative | - Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë makinerive sipas skemës/manualeve dhe rregullave. - Ndarje e përgjegjësisë dhe adresimi i saktë për raste të incidenteve/aksidenteve gjatë procesit të punës dhe mënyrat e veprimit. |

Masat teknike, proceset selektive dhe kontrolli i ndotjes

- Pastrimi periodik i ambientit të brendshëm dhe të jashtëm të aktivitetit.

- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara.
- Respektimi i orareve të punës.
- Plotësimi dhe respektimi i kushteve teknike të operimit të punës.
- Përdorimi i pajisjeve/aparaturave të Certifikuara sipas Standartit European.
- Sigurimi i ambienteve të punës.
- Zhurmat ne ambjentet e Parkut Industrial jane relativisht te uleta, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave.
- Respektimi i kushteve teknike dhe standarte.
- Zbatimi i rregullores se brendshme.
- Inspektim vizual ditor.
- Përdorimi i mjeteve te kolauduara.
- Pajisje per mbrojtjen e punonjesve gjate proceseve te tyre te punes.

8. MONITORIMI I PLANIFIKUAR

Qëllimi i monitorimit mjedisor

Te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, per te vleresuar shkallen e ndikimit (nese ka), si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Objektivat e monitorimit

- Te krahasoje cilesine dhe gjendjen e mjedisit para fillimit te aktivitetit me ate gjate funksionimit te instalimit.
- Te monitoroje emetimet (nese ka) ne te gjitha fazat e zhvillimit te projektit, ne perputhje me normat dhe standartet ligjore te Shqiperise dhe BE.
- Te percaktoje nese ndryshimet e mundshme mjedisore jane si rezultat i zhvillimeve te aktiviteve qe kryhen ne rajonin ku ndodhet objekti ku kryhet funksionimi dhe nese ka lidhje me impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Te percaktoje efektivitetin e masave permiresuese te zbatuara
- Per te percaktuar impaktet afatgjata (nese ka).
- Per te percaktuar zgjatjen e kthimit ne normalitet te cilesise se mjedisit ne rajon, ne rastet kur vleresohet se ka ndikime dhe impakte ne te.
- Te krijojte nje arkive (regjister) te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe do te mund te perdoret ne te ardhmen.
- Per te garantuar pershtatshmerine e nje objekti mjedisor per ta perdorur per qellime te caktuara.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi

mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim mjedisor i detajuar dhe një program trajnimi.

Përbërësit kryesorë të këtij programi duhet të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm.
- Mirëkuptim i informacionit të përgjithshëm, i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsyet për një menaxhim mjedisor të mirë.
- Përdorimi i pajisjeve/aparaturave të Certifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave.
- Respektimi i orareve të punës brenda ambientit ku zhvillohet veprimtaria.
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparaturave çdo fillim viti për mirëfunksionimin e tyre.
- Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve / aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme nga punonjësit për operimin e punës si : doreza, kufje per zhurmat; syze etj, sipas nevojës dhe proceseve që zhvillohen.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, mbetjeve etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesorë të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.

- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat C1, C2, C5, C7, C8 të vendimit Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis gjatë fazës operative:

- Për ajrin aplikohen detyrime.
- Për ujin, aplikohen detyrime.
- Për zhurmat aplikohen detyrime.

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportim për lejet e tipit A çdo 3 (tre) muaj ose 4 (katër) here në vit.

